



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	09.09.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Gusht

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.08.2025 deri me 30.08.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit gusht, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka realizuar një varg aktiviteteve dhe iniciativash që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor, si promovimin e prodhimeve vendore. Mbështetja me infrastrukturë bujqësore, bashkëpunimi me organizata vendore e ndërkombëtare, monitorimi i montimit të serave dhe organizimi i panairëve promovuese.

Është bërë nënshkrimi i kontratave me fermerët përfitues të listës pritëse për montimin e serave.

Operatorët kanë filluar procesin e montimit dhe deri më tani janë përfunduar mbi 40% e serave.

Menaxheri i kontratës, bashkë me stafin e Drejtorisë, ka dalë në terren për të monitoruar nga afër punimet dhe respektimin e standardeve.

Më 15 gusht është mbyllur thirrja publike, e hapur për 15 ditë kalendarike, në kuadër të projektit të përbashkët me organizatën Qatar Charity dhe Komunën e Lipjanit.

Projekti ka për qëllim mbështetjen e fermerëve me sera dhe motokultivatorë.

Pas mbylljes së thirrjes, komisioni i organizatës ka filluar vizitat në terren për të vlerësuar secilin aplikues.

Është hapur aplikimi për pagesat direkte të Ministrisë së Bujqësisë për fermerët që kanë dorëzuar grurin e korrur gjatë muajit korrik.

Procesi i aplikimit ka kaluar me sukses dhe pa vonesa falë menaxhimit të mirë dhe angazhimit të stafit të Drejtorisë.

Stafi i Drejtorisë ka dalë në terren për të evidentuar dhe raportuar dëmet e shkaktuara nga faktorë të ndryshëm në tokat bujqësore, duke iu përgjigjur kërkesave të fermerëve.

Janë zhvilluar takime me organizata të huaja, me synim krijimin e partneriteteve të reja dhe implementimin e projekteve zhvillimore gjatë muajve të ardhshëm.

Është organizuar Panairi i Produkteve Vendore në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan, i cili ka zgjatur tri ditë.

Panairi ka qenë një mundësi e shkëlqyer për promovimin e produkteve bujqësore vendore dhe për forcimin e lidhjes mes prodhuesve dhe konsumatorëve.

Pjesëmarrja dhe interesi i madh i qytetarëve dëshmoi rëndësinë dhe vlerën e këtij aktiviteti për komunitetin.

Muaji gusht ishte një periudhë dinamike për Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Komunës së Lipjanit. Aktivitetet e ndërmarra kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë tek fermerët, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të tyre të punës dhe në zhvillimin e sektorit bujqësor në përgjithësi.